

## KONTRATË EKZEKUTIMI I SHITBLERJES SE PJESËVE TË KAPITALIT

**Plus Communication sh.a.**, me seli ligjore në Tiranë, Rr. Ibrahim Rugova, Pallati i Ri përballë Gardës, NUIS K91811014B, me përfaqësues ligjor Znj. Matilda Shehu, shtetase shqiptare e lindur ne Korce, me 27 prill 1973, me letërnjoftim nr. 027825846 (në vijim "**Shitësi**");

dhe

**Hightel Towers Albania sh.p.k.**, me seli ligjore në Njësia Bashkiake nr. 5, Rr. Nikolla Tupe, pallati nr. 2, kati i 3<sup>ta</sup>, apartamenti 6, NUISL4222001F, me përfaqësues ligjor Z. Artan Xhori, shtetas shqiptar i lindur ne Vlore, me 16 tetor 1963, me letërnjoftim nr. 024405094, (në vijim "**Blerësi**").

(Në vijim Shitësi dhe Blerësi do të përcaktohen bashkërisht si "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**")

### Kushtet paraprake

- A) Shitësi është pronar i shumices absolute të kapitalit themeltar të shoqërisë Plus Network sh.p.k., me seli ligjore në Tiranë, Rr. Ibrahim Rugova, Pallati i Ri përballë Gardës, me NUISL42404007P ("**Shoqëria**") e cila ka nje kapital themeltar te barabarte me ALL 1,659,610,000;
- B) Blerësi është pronar i pakices te kapitalit themeltar të Shoqërisë
- C) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit, i cili pranon, nje pjese kuote te kapitalit të Shoqërisë e cila perfaqeson 6,99982% (gjashte presje 99982 per qind) te kapitalit themeltar te saj ("**Kuota Target**") sipas kushteve të mëposhtme.

Palët, duke marrë parasysh sa më sipër, pranojnë të lidhin këtë kontratë që ekzekuton shitjen e Kuotes Target (në vijim "**Kontrata**") sipas kushteve të mëposhtme:

### Neni 1

#### Kushtet paraprake

Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë thelbësore dhe integrale e kësaj Kontrate.

### Neni 2

#### Shitja e Kuotes Target

- 2.1 Njëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi i shet dhe i transferon Blerësit i cili, pranon dhe blen, pronesine e Kuotes Target, kundrejt vleres te saj nominale, sipas kushteve dhe termave te parashikuar ne kete Kontrate. Çmimi i konkorduar mes paleve per transferimin e Kuotes Target është paguar paraprakisht nga Shitësi tek Blerësi.
- 2.3 Transferimi i pronesise i Kuotes Target nga Shitesit tek Bleresi do te jete efektiv ne datën e kësaj Kontrate.

### Neni 3

#### Deklarime dhe Garanci të Shitësit

- 3.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i Kuotes Target dhe të drejtave që rrjedhin prej tyre.

**Neni 4**  
**Korrespondenca**

- 4.1 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen pranë selisë së Blerësit dhe të Shitesit.
- 4.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të dërgohen me anë të letrës rekomande me kthim përgjigje ose me faks.
- 4.3 Çdo informacion, kërkesë ose njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme: a) nëse është dërguar me faks, në momentin në të cilin është marrë faksi; b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.

**Neni 5**  
**Shpenzime dhe taksa**

- 5.1 Do të jenë në ngarkim të Blerësit taksat, taksat e pullave dhe shpenzimet noteriale për lidhjen e Kontratës.

**Neni 6**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet eskuzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 7**  
**E drejta e zbatueshme**

Kjo Kontratë dhe të drejtat e detyrimet e Palëve do të rregullohen në bazë të së drejtës shqiptare.



**Neni 8**  
**Vlefshmëria - Origjinalet**

Kjo Kontratë bëhet e vlefshme me nënshkrimin e saj nga Palët. Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, në version dy gjuhësor shqip dhe anglisht, të gjitha të nënshkruara nga Palët. Në rast mos-përputhje mes versioneve shqip dhe anglisht, ky i fundit mbizoteron. Kjo Kontratë nënshkruhet nga të dyja Palët, më datë 22.06.2016

\* \* \*

SHITËSI

PerPlus Communication sh.a.

BLERËSI

Per Hightel Towers Albania sh.p.k.

